

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **MINISTRIA E MBROJTJES**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **217-25-5993-1-1-1**

Nr i brendshëm: **21700/25/023/111**

Sa i përket tenderit për: **Ritender - Furnizim me jelek taktik - SUFSK 1001 për nevojat e FSK-së**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

GOE RUNWAY SH.P.K.- & -Sabit Makiqi B.I. A & V – Collection

Rr.Luan Haradinaj, Pallati i Rinisë Nr.30, 10,000, Prishtinë, Kosovë
Prishtinë 10 000

044 477 000

Agron Makiqi

Runway.ks@gmail.com



24.06.2026

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

1. Njoftimi për kontrate i datës 03.07.2025
2. Dosja e tenderit e korrigjuar e datës 27.10.2025
3. Procesverbali i hapjes i datës **17.11.2025**
4. Njoftimi mbi vendimin e AK-se B-58, i datës 20.02.2026. *Hera e pare!*
5. Njoftimi mbi vendimin e AK-se B-58, i datës 10.06.2026. *Hera e dyet!*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

Po Jo

Procesverbali i hapjes është pranuar përmes platformës së e-prokurimit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

Po Jo

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,

Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës.

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse të RrPP-se 02/2024.

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse të Udhëzuesit 02/2024

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Te pa kënaqur me njoftimin e date 10.06.2026 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues **MINISTRIA E MBROJTJES** ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: **Ritender - Furnizim me jelek taktik - SUFSK 1001 për nevojat e FSK-së** me nr. te prokurimit: **217-25-5993-1-1-1** dhe Nr. i brendshëm: **21700/25/023/111** në afatin ligjor komfor nenit 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, pranë Autoritetit kontraktues **MINISTRIA E MBROJTJES** ushtrojmë këtë:

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Për shkak se AK- **MINISTRIA E MBROJTJES**:

- ne mënyre te kundërligjshme e ka rekomanduar për kontratë ne këtë aktivitet te prokurimit ne kundërshtim me nenin 59 dhe ne kundërshtim me nenin 9.1&9.2 te dosjes se tenderit ku konsiderojmë se qëllimisht kan vepruar edhe kunder OSHP-se – kunder vendimit te OSHP-se kur e ka rekomanduar GOE Hasan Gjesha dhe Özyigit Textile Makine Gida Turizm Insaat Ve Petrol Urunleri Paz San Ve Tic Ltd Sti.

Sqarojmë ne mënyrë të detajuar:

Pretendimi 1.1

Operatori Ekonomik i rekomanduar, Hasan Gjesha dhe Özyigit Textile Makine Gida Turizm Insaat Ve Petrol Urunleri Paz. San. Ve Tic. Ltd. Şti., me Vendimin e OSHP-së të datës 20.04.2026, në lëndët me numër **OSHP: 2026/0132, OSHP: 2026/0136, OSHP: 2026/0141 dhe OSHP: 2026/0144**, është vlerësuar si Operator Ekonomik i papërgjegjshëm për shkak të mospërmbushjes së kërkesave të Dosjes së Tenderit - atestet. Duke pasur parasysh konstatimet dhe gjetjet e përfshira në vendimin e lartcekur të OSHP-së, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar që gjatë rivlerësimit të zbatojë në tërësi vendimin e OSHP-së dhe të veprojë në përputhje me konstatimet e dhëna në atë vendim lidhur me atestet.

Pra, Autoriteti Kontraktues ka vazhduar shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së Operatorit Ekonomik Hasan Gjesha dhe Özyigit Textile Makine Gida Turizm Insaat Ve Petrol Urunleri Paz. San. Ve Tic. Ltd. Şti., pavarësisht faktit se OSHP-ja kishte trajtuar çështjet kontestuese lidhur me përgjegjshmërinë e këtij operatori ekonomik dhe kishte nxjerrë konstatime të qarta lidhur me atestet te cilat ka pas mospërmbushjen e kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Me këtë veprim, **Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me shqyrtimin e vendimit të OSHP-së**, duke mos i dhënë efekt të plotë konstatimeve dhe udhëzimeve të organit kompetent për shqyrtimin e ankesave në prokurimin publik. Vendimet e OSHP-së janë përfundimtare dhe janë detyruese për Autoritetin Kontraktues. Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar që të zbatojë plotësisht konstatimet e **OSHP-së** dhe të mos veprojë në kundërshtim me to gjatë procesit të rivlerësimit.

Andaj, konsiderojmë se rekomandimi i Operatorit Ekonomik Hasan Gjesha dhe Özyigit Textile Makine Gida Turizm Insaat Ve Petrol Urunleri Paz. San. Ve Tic. Ltd. Şti. është bërë në kundërshtim me konstatimet e vendimit të OSHP-së dhe kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të zbatojë në tërësi

vendimin e OSHP-së, duke e trajtuar ofertën në përputhje me gjetjet dhe arsyetimin e dhënë në atë vendim.

Pretendimi 1.2

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Mbrojtjes, më datë 10.06.2026, ka publikuar Njoftimin B58, përmes të cilit ka rekomanduar për dhënie të kontratës Grupin e Operatorëve Ekonomikë Hasan Gjesha dhe Özyigit Textile Makine Gıda Turizm Insaat Ve Petrol Urunleri Paz. San. Ve Tic. Ltd. Şti. Megjithatë, OE i rekomanduar konsiderohet i papërgjegjshëm, pasi nuk ka përmbushur kërkesat e Dosjes së Tenderit, saksisht kërkesën nr. 15 të përcaktuar në kriteret teknike dhe profesionale (9.1 & 9.2), ku kërkohet shprehimisht:

"Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë ateste nga një laborator i akredituar për produktet e ofertuara, sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit."

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga GOE i rekomanduar shihet se në vend të atesteve apo raporteve të testimit të lëshuara nga një laborator i akredituar, janë dorëzuar dokumente të cilat paraqesin vetëm **specifika teknike të kopjuar** dhe rezultate të përgjithshme të lëshuara nga Universiteti Hacettepe në Ankara, përkatësisht nga **Fakulteti i Edukimit Programi I Edukimit Kimi dhe Fakulteti i Inxhinierisë Kimike programi Inxhinierisë Kimike**.

Dokumentet e dorëzuara nga GOE i rekomanduar nuk përbëjnë raporte zyrtare testimi apo ateste në kuptimin e kërkesës së Dosjes së Tenderit, pasi keto dokumente të dorëzuara nuk identifikohet operatori ekonomik apo prodhuesi që ka paraqitur produktin për testim, nuk evidentohet numri i akreditimit të laboratorit që ka kryer testimet, nuk është dëshmuar se laboratorit që ka kryer testimet është i akredituar sipas standardit ISO/IEC 17025, dokumentet e dorëzuara nuk dëshmojnë se testimet janë kryer për produktin konkret të ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit, si dhe kërkesa baze nuk ka prova se programet e drejtimit të Kimisë "laboratory" në fjalë është i autorizuar dhe i akredituar për kryerjen e testimeve të tekstit sipas standardeve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Pra, në dokumentacionin e dorëzuar nuk është dëshmuar se testimet janë realizuar sipas standardeve të kërkuara në Dosjen e Tenderit, saksisht:

Tensile Strength (Warp) – ISO 13934-1;

Tensile Strength (Weft) – ISO 13934-1;

Tear Resistance – ISO 13937-1;

Color Fastness to Light – ISO 105-B04.

Nga verifikimi i informacionit publik të Universitetit Hacettepe shihet se universiteti është i akredituar për programe akademike dhe veprimtari arsimore, ndërsa nuk evidentohet ekzistenca e një laboratorit të akredituar për testime të tekstit sipas standardit ISO/IEC 17025, siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit. Një universitet apo fakultet, pavarësisht statusit të tij publik ose akademik, nuk nënkupton automatikisht se laboratorët e tij brenda Universitetit - fakultetit janë të akredituar për të

lëshuar raporte zyrtare testimi të vlefshme për procedura të prokurimit publik. Për këtë arsye, OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar përmbushjen e kërkesës nr. 15 të Dosjes së Tenderit.

Pretendimi 1.3

Me këto konstatime se komisioni I vlersimit nuk ka qene profesional dhe ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59 te LPP-se pasi se vlerësimi i ofertës së GOE Hasan Gjesha dhe Özyigit Textile Makine Gida Turizm Insaat Ve Petrol Urunleri Paz. San. Ve Tic. Ltd. Şti. Eshte I pa përgjegjshme është bërë në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë nuk ka qene ne kete vlersim. Ky komision ka vepruar edhe ne kundërshtim me RRPP nenin 40 pasi eshte është përgjegjës për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e Tenderëve në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP. Komisioni I vlersimit ka per detyre qe ofertat të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do t'i jepet OE që i ka plotësuar kriteret. **Autoriteti Kontraktues nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kriteret ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve sic ka vepruar me OE te rekomanduar duke pranuar certifikata te Universitetit te Ankaras ne vend te certifikatave te Laboratorit , duke pranuar kinse atestet te pa qene fare ateste duke pranuar testime te pa u qertifikuar testime te Universiteti e OE fare nuk ka ateste sipas standardit ISO andaj kërkojmë që Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim.**

Me këto pretendime, ne si Operator Ekonomik ankues vlerësojmë se mosrespektimi i qëllimshëm i kriterëve të vlerësimit të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe trajtimi i pabarabartë i operatorëve ekonomikë mund të ngrejë dyshime për ekzistimin e elementeve të përgjegjshisë penale. Andaj, kërkojmë që rasti të shqyrtohet edhe nga organet kompetente, nëse ato vlerësojnë se ekzistojnë bazat ligjore për ndërmarrjen e veprimeve të mëtejshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pra, duke pasur parasysh mënyrën e vlerësimit të ofertave dhe pranimit e dokumenteve të cilat, sipas vlerësimit tonë, nuk i përmbushin kërkesat e Dosjes së Tenderit, krijohet dyshimi se operatori ekonomik i rekomanduar është favorizuar nga Komisioni i Vlerësimit dhe Autoriteti Kontraktues. Këto veprime ngrejë dyshime se individë të caktuar mund të kenë vepruar për interesa personale ose për përfitim te operatorit ekonomik të rekomanduar I cili mundet te jete I njofshem I ndonje personi brenda AK-së, e duke dëmtuar drejtpërdrejt neve si operator ekonomik dhe duke cenuar parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe trajtimit të barabartë në procedurat e prokurimit publik.

Për këtë arsye, përveç dorzimit te të kësaj ankese, do t'u drejtohem edhe organeve kompetente për të vlerësuar nëse në veprimet e Komisionit të Vlerësimit dhe të Autoritetit Kontraktues ekzistojnë elemente që mund të ngrejë dyshime për përgjegjësi penale ose përgjegjësi tjetër ligjore.

Pretendimi 1.4

Autoriteti Kontraktues I Ministrise se Mbrojtjes ka bere shkelje te rende te LPP-se pasi nuk ka pasur te drejt te kerkoj sqarime shtes per raport te analizave te Universitetit te Ankaras pasi OE I rekomanduar I ka dorezuar njeher keto kense Ateste nga ky Univerzitet te kopjuar sipas specifikave! dhe kane qene te pa pranushme nga Komisioni I vlersimit I pari dhe eshte eliminuar nga AK-ja ne

vlersimin e pare. Gjithashtu nese bazohem edhe ne nenin 59 te LPP_s dhe ne UDHËZUES Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK saksisht nenin 10 ceket :

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-së
Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu ("specifikimit teknik" – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzoj specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara.	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	28
Ështëdorëzuar katalogu/testime por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

Për më tepër, Udhëzuesi Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik përcakton qartë se kur mungojnë dokumentet teknike thelbësore ose kur dokumentet e dorëzuara nuk përmbushin kërkesat e Dosjes së Tenderit, oferta duhet të refuzohet pa kërkuar informacion shtesë që do të rezultonte në plotësimin ose korrigjimin e mangësive substanciale të ofertës. Prandaj, kërkesa e Autoritetit Kontraktues për sqarime në këtë rast ka pasur për efekt mundësimin e plotësimin të një mangësie substanciale të ofertës dhe jo thjesht sqarimin e një dokumenti ekzistues, gjë që bie ndesh me parimet e trajtimit të barabartë dhe të transparencës në procedurat e prokurimit publik.

Operatori Ekonomik i rekomanduar kishte dorëzuar dokumente të lëshuara nga Universiteti Hacettepe në Ankara si dëshmi për testimet dhe atestet e kërkuara nga Dosja e Tenderit. Megjithatë, këto dokumente nuk përbënin ateste apo raporte testimi të lëshuara nga një laborator i akredituar sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit. Për këtë arsye, gjatë vlerësimit fillestar oferta ishte konsideruar e papërgjegjshme.

Pavarësisht kësaj, Autoriteti Kontraktues, përmes Letrës Standarde të Sqarimit të datës 15.05.2026, ka kërkuar informata shtesë për të vërtetuar nëse Universiteti Hacettepe apo laboratori përkatës ishte i akredituar për kryerjen e testeve sipas standardeve:

Shihe sqarimin e dergua nga OE rekomanduar:

Dokumenti	Sqarimi
1. Certifikatë e Themelimit të Universitetit Shtetëror (përkthim në gjuhën shqipe dhe origjinale në turke)	Dëshmon se Hacettepe University është universitet shtetëror i themeluar zyrtarisht në Turqi dhe i njohur nga YÖK.
2. Accredited Departments.pdf (në gjuhën turke dhe angleze)	Dëshmon se Hacettepe ka programe të akredituara, përfshirë programe të inxhinierisë dhe Inxhinieri Kimike.
5. Mudek_Acreditation 1.jpg dhe 6. Mudek_Acreditation 2.jpg	Dëshmojnë se Chemical Engineering / Kimya Mühendisliği është i akredituar nga MÜDEK / EUR-ACE për periudhën 30.09.2021–30.09.2026.
7. Research Areas Report.pdf	Ky dokument dëshmon se Hacettepe University ka infrastrukturë kërkimore/laboratorike, përfshirë laboratorë

	dhe qendra që ofrojnë shërbime të testimit dhe matjes sipas standardeve shtetërore dhe ndërkombëtare.
6. QUALITY ASSURANCE AND QUALITY COMMISSION DIRECTIVE 2023.pdf (në gjuhën turke dhe angleze)	Dëshmon se universiteti ka sistem formal të sigurimit të cilësisë dhe strukturë të brendshme të kontrollit institucional.
7. Corporate Accreditation Report 8. MIDTERM EVALUATION REPORT Eng 9. INTERNAL INSTITUTIONAL EVALUATION REPORT Eng (në gjuhën turke dhe angleze)	Dëshmojnë vlerësim/akreditim institucional dhe funksionim të sistemit të cilësisë në universitet.

Nga dokumentacioni sqarues i dorëzuar nga Operatori Ekonomik rezulton se nuk është ofruar asnjë dëshmi që laboratorit në fjalë **NUK posedon akreditim sipas standardit ISO/IEC 17025** dhe asnjë dokument që dëshmon fushëveprimin e akredituar (Scope of Accreditation) për kryerjen e testeve sipas standardeve të kërkuara në Dosjen e Tenderit.

Në vend të kësaj, Operatori Ekonomik ka dorëzuar dokumente që lidhen me akreditimin akademik të programeve universitare, përfshirë akreditime nga MÜDEK dhe EUR-ACE. Këto akreditime kanë të bëjnë me cilësinë e programeve të studimit dhe **Nuk përbëjnë dëshmi se laboratorit përkatës është i akredituar për teste teknike sipas standardit ISO/IEC 17025.**

Po ashtu, nuk është paraqitur asnjë dëshmi se laboratorit është i akredituar nga TÜRKAK ose nga ndonjë organ tjetër kompetent i njohur ndërkombëtarisht për kryerjen e testeve sipas standardeve ISO 13934-1, ISO 13937-1 dhe ISO 105-B04.

Dokumentet e dorëzuara si raporte hulumtuese, rregullore të brendshme universitare apo dokumente të tjera akademike nuk mund të konsiderohen raporte zyrtare testimi dhe nuk mund të zëvendësojnë kërkesën e Dosjes së Tenderit për ateste të lëshuara nga laboratorit të akredituar.

Pra, Operatori Ekonomik i rekomanduar nuk ka dëshmuar se "laboratorit"(universiteti I Ankaras) që ka lëshuar dokumentet e dorëzuara është i akredituar për kryerjen e testeve sipas standardeve të kërkuara në Dosjen e Tenderit. Për pasojë, oferta e tij duhej të ishte refuzuar si e papërgjegjshme dhe jo të rekomandohej për dhënie të kontratës. Prandaj kërkojmë që Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të anulohet dhe lënda të **kthehet në rivlerësim**, me obligim që ofertat të vlerësohen në përputhje të plotë me kërkesat e Dosjes së Tenderit, Ligjin për Prokurimin Publik dhe aktet nënligjore në fuqi.

Pretendimi 1.5

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ofertës së Grupit të Operatorëve Ekonomikë Hasan Gjesha dhe Özyigit Textile Makine Gıda Turizm İnfaat Ve Petrol Urunleri Paz. San. Ve Tic. Ltd. Şti., kemi konstatuar se produkti i ofruar nuk i përmbush specifikimet teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

NE Mostre e dorëzuar të jelekut për xhepin e mesëm, në specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit është kërkuar që lartësia të jetë 18 cm, ndërsa nga dokumentacioni i dorëzuar nga GOE rezulton se është ofruar lartësi prej vetëm 16 cm.

Po ashtu, për xhepat anësorë, Dosja e Tenderit kërkon lartësi prej 20 cm, ndërsa GOE ka ofruar lartësi prej 12 cm. Gjithashtu, për gjerësinë e xhepave anësorë është kërkuar dimensiononi 10 cm, ndërsa GOE ka ofruar dimension prej 9.5 cm.

Këto dallime paraqesin devijime të medha, përbëjnë mospërputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit. Pra, oferta e GOE nuk mund të konsiderohet në përputhje me kërkesat teknike të aktivitetit të prokurimit, vlerësimi i kësaj oferte si e përgjegjshme është bërë në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Duke u bazuar në sa më sipër, kërkojmë që ky pretendim të merret parasysh dhe që oferta e GOE Hasan Gjesha dhe Özyigit Textile Makine Gıda Turizm İnsaat Ve Petrol Urunleri Paz. San. Ve Tic. Ltd. Şti. të rivlerësohet në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe legjislacionin në fuqi.

Pretendimi 2

Lidhur me Operatorin Ekonomik **SSI LOG L.L.C.**, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me Vendimin e OSHP-së dhe ka zbatuar në mënyrë korrekte konstatimet dhe udhëzimet e dhëna në atë vendim. Për rrjedhojë, si Operator Ekonomik ankues, pajtohem me vlerësimin dhe trajtimin e bërë nga Autoriteti Kontraktues ndaj këtij Operatori Ekonomik.

Shikoni Vendimin e OSHP-së.

Ndërsa ekspertja shqyrtuese znj Huruglica sipas raportit të ekspertizes me nr : 2026/0136 ndryshe nga eksperti zt Hoxha lidhur me listen e kontratave të OE të rekomanduar për çka ishte pretendim ankimor deklaroi që në listen ka të bashkangjitur furnizime të cilat nuk janë te natyres së njejte apo të ngjajshme kështu duke ofruar si shembull baby box që e te tjera dhe se nuk e përmbush vlerën e kërkuar sipas NJK dhe DT prej jo me pak se; 500,000.00 €. Ndërsa sa i përket Iso standardeve 105-B04 dhe 105-B02 deklaroi *OE ankues ka parashtruar pretendime ankimore edhe për raportin e testimit të mostrave, për të cilat ngjyra është kërkuar që të testohet sipas ISO standardit 105-B04. Ky standard dallon nga ISO 105-B02, për faktin se ISO standardi i kërkuar ka të bëjë me testimin e materialit në ambientin e jashtëm ndaj diellit, lagështisë etj., ndërsa ISO standardi 105-B02 ka të bëjë me testimin e materialit të brendshëm ndaj dritës artificiale. Po ju prezantoi edhe manualin për dy ISO standardet dhe, si e tillë, meqë jelekët janë më tepër për përdorim të jashtëm, gjithashtu marrë parasysh se edhe kërkesë e AK-së ka qenë pikërisht kjo kërkesë, atëherë edhe kam aprovuar pretendimin ankimor të OE ankues si të bazuar. ndërsa PSH, vlerëson fakti se meqenëse AK-ja ka kërkuar specifikisht standardin ISO 105-B04 për shkak të destinimit të produktit, Paneli konsideron se duhet ti jepet përparësi vetë kërkesës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit ku dihet që ky standard mbetet kriteri bazë i vlerësimit, andaj çdo vlerësim i ofertave duhet të bëhet në përputhje të plotë me specifikimet teknike që AK-ja ka konsideruar të nevojshme për këtë furnizim .*

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të raporteve të ekspertizave , deklarimeve të palëve në seancë, si dhe analizimit të dokumentacionit të lëndës, Paneli Shqyrtues vlerëson se raportet e ekspertit shqyrtues të z.Hoxha që mbështesin ekuivalencën e pa argumentuar nuk mund të merren si bazë për vendimmarrjetë kjo duke u bazuar në provat e administruara sikurse ato të përshkruar më lartë PSH ka vendosur se OE Hasan Gjesha B.I., me nr. 2026/0132, e datës 05.03.2026, OE Fitim R. Bilalli B.I., me nr 2026/0141 e datës 07.03.2026si dhe ankesa e OE PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo., me nr. 2026/0144 e datës 09.03.2026 duhet të aprovohen si pjesërishtë të bazuara.

Pretendimi 3.

Lidhur me Operatorin Ekonomik **GOE ECO CLEAN CORPORATION SH.P.K.**, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me Vendimin e OSHP-së dhe ka zbatuar në mënyrë korrekte konstatimet dhe udhëzimet e dhëna në atë vendim. Për rrjedhojë, si Operator Ekonomik ankues, pajtohem me vlerësimin dhe trajtimin e bërë nga Autoriteti Kontraktues ndaj këtij Operatori Ekonomik.

Pretendimi 4

Gjatë shqyrtimit të ofertës së Operatorit Ekonomik **Fitim R. Bilalli B.I.**, kemi konstatuar se i njëjti nuk i përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit për këto arsye:

1. Nuk ka dorëzuar referencat dhe dëshmitë përcjellëse në përputhje me Evidencën nr. 9 të Dosjes së Tenderit. Duke qenë se Dosja e Tenderit ka përcaktuar qartë se kontratat pa referenca pozitive ose fletëpranime nuk do të merren parasysh, OE nuk e ka përmbushur kriterin minimal të kualifikimit.
2. Nuk ka dorëzuar ateste të lëshuara nga laborator i akredituar dhe nuk ka dëshmuar akreditimin e laboratorit sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit. Gjithashtu, nuk janë paraqitur testime sipas standardeve të kërkuara ISO 13934-1, ISO 13937-1 dhe ISO 105-B04.
3. Në vend të standardit të kërkuar ISO 105-B04, OE ka paraqitur testim sipas standardit ISO 105-B02, i cili nuk është ekuivalent dhe nuk e përmbush kërkesën e Autoritetit Kontraktues.
4. Nga ekzaminimi i mostrës janë konstatuar mospërputhje me specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit, pasi për xhepin anësor është kërkuar lartësia 20 cm dhe gjerësia 10 cm, ndërsa OE ka ofruar lartësi 17 cm dhe gjerësi 15 cm.

Pra, oferta e Operatorit Ekonomik **Fitim R. Bilalli B.I.** nuk i përmbush kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, andaj e njëjta duhet të konsiderohet e papërgjegjshme dhe të refuzohet në përputhje me nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Lidhur me **Operatorin Ekonomik Fitim R. Bilalli B.I.**, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me Vendimin e OSHP-së dhe ka zbatuar në mënyrë korrekte konstatimet dhe udhëzimet e dhëna në atë vendim. Për rrjedhojë, si Operator Ekonomik ankues, pajtohem me vlerësimin dhe trajtimin e bërë nga Autoriteti Kontraktues ndaj këtij Operatori Ekonomik.

Pretendimi 5.

Operatori Ekonomik **Sodex Group SH.P.K.** nuk ka përmbushur kërkesën e Evidencës nr. 15 të Dosjes së Tenderit, sipas së cilës kërkohet dorëzimi i atesteve të lëshuara nga laborator i akredituar për produktet e ofertuara.

Nga dokumentacioni i dorëzuar se OE nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për akreditimin e laboratorit që ka kryer testimet dhe nuk ka dorëzuar raporte testimi sipas standardeve të kërkuara në Dosjen e Tenderit, respektivisht ISO 13934-1, ISO 13937-1 dhe ISO 105-B04.

Për më tepër, në vend të standardit të kërkuar ISO 105-B04, OE ka paraqitur raport testimi sipas standardit ISO 105-B02, i cili nuk është ekuivalent dhe nuk e përmbush kërkesën e Autoritetit Kontraktues. Për rrjedhojë, dokumentacioni teknik i paraqitur nuk dëshmon përmbushjen e specifikimeve të kërkuara në Dosjen e Tenderit.

Pranimi i një dokumentacioni të tillë bie ndesh me kërkesat e Dosjes së Tenderit, nenin 59 të LPP-së dhe parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, pasi Autoriteti Kontraktues është i obliguar të vlerësojë ofertat vetëm mbi bazën e kriterëve dhe standardeve të publikuara paraprakisht.

Lidhur me Operatorin Ekonomik Sodex Group SH.P.K konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me Vendimin e OSHP-së dhe ka zbatuar në mënyrë korrekte konstatimet dhe udhëzimet e dhëna në atë vendim. Për rrjedhojë, si Operator Ekonomik ankues, pajtohem me vlerësimin dhe trajtimin e bërë nga Autoriteti Kontraktues ndaj këtij Operatori Ekonomik.

Pretendimi 6

Lidhur me Operatorin Ekonomik PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me Vendimin e OSHP-së dhe ka zbatuar në mënyrë korrekte konstatimet dhe udhëzimet e dhëna në atë vendim. Për rrjedhojë, si Operator Ekonomik ankues, pajtohem me vlerësimin dhe trajtimin e bërë nga Autoriteti Kontraktues ndaj këtij Operatori Ekonomik.

Shikoni Vendimin e OSHP-së.

Ndërsa ekspertja shqyrtuese znj Huruglica sipas raportit të ekspertizes me nr : 2026/0136 ndryshe nga eksperti zt Hoxha lidhur me listen e kontratave të OE të rekomanduar për çka ishte pretendim ankimor deklaroj qe në listen ka të bashkangjitur furnizime të cilat nuk jane te natyres së njejte apo të ngjajshme kështu duke ofruar si shembull baby box qe e te tjera dhe se nuk e përmbush vlerën e kërkuar sipas NJK dhe DT prej jo me pak se; 500,000.00 €. Ndërsa sa i përket Iso standardeve 105-B04 dhe 105-B02 deklaroj OE ankues ka parashtruar pretendime ankimore edhe për raportin e testimit të mostrave, për të cilat ngjyra është kërkuar që të testohet sipas ISO standardit 105-B04. Ky standard dallon nga ISO 105-B02, për faktin se ISO standardi i kërkuar ka të bëjë me testimin e materialit në ambientin e jashtëm ndaj diellit, lagështisë etj., ndërsa ISO standardi 105-B02 ka të bëjë me testimin e materialit të brendshëm ndaj dritës artificiale. Po ju prezantoj edhe manualin për dy ISO standardet dhe, si e tillë, meqë jelekët janë më tepër për përdorim të jashtëm, gjithashtu marrë parasysh se edhe kërkesë e AK-së ka qenë pikërisht kjo kërkesë, atëherë edhe kam aprovuar pretendimin ankimor të OE ankues si të bazuar. ndërsa PSH, vlerëson fakti se meqenëse AK-ja ka kërkuar specifikisht standardin ISO 105-B04 për shkak të destinimit të produktit, Paneli konsideron se duhet ti jepet përparësi vetë kërkesës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit ku dihet që ky standard mbetet kriteri bazë i vlerësimit, andaj çdo vlerësim i ofertave duhet të bëhet në përputhje të plotë me specifikimet teknike që AK-ja ka konsideruar të nevojshme për këtë furnizim .

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të raporteve të ekspertizave , deklarimeve të palëve në seancë, si dhe analizimit të dokumentacionit të lëndës, Paneli Shqyrtues vlerëson se raportet e ekspertit shqyrtues të z.Hoxha që mbështesin ekuivalencën e pa argumentuar nuk mund të merren si bazë për vendimmarrjetë kjo duke u bazuar në provat e administruara sikurse ato të përshkruar më lartë PSH ka vendosur se OE Hasan Gjesha B.I., me nr. 2026/0132, e datës 05.03.2026, OE Fitim R. Bilalli B.I., me nr 2026/0141 e datës 07.03.2026si dhe ankesa e OE PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo., me nr. 2026/0144 e datës 09.03.2026 duhet të aprovohen si pjesërishtë të bazuara.

Pretendimi 7

Siç po shihet me larte AK-ja ka rekomanduar kundërligjshëm këtë aktivitet te prokurimit GOE pasi nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT pra oferta nuk është i përgjegjshëm qe bije se është shkelur nenin 60 i LPP-së me tender te përgjegjshëm dhe me **Çmimin më te ulët**.

AK për këtë aktivitet te prokurimit: ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës ka qenë: Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më te ulët**, ku neve kemi ofertuar me Tender të **përgjegjshëm** dhe me **Çmimin më te ulët**.

Pra ne kemi dorëzuar tender i cili është ne përputhshmëri me te gjitha kërkesat e parashtruara ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit dhe me **Çmimin më te ulët**.

Me këtë veprim AK ka bere shkelje te nenit 1 te LPP-së ku thuhet se: *vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale te ndonjë individi brenda AK-se, duhet të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.*

Pretendimi 8

Gjithashtu shihet qarte se AK ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-së ku ne piken 1 thuhet se : *Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

Si dhe ne piken 2 thuhet :

Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

AK nuk i ka vlerësuar ne mënyrë te barabarte ofertën tone te cilët kane aplikuar ne këtë aktivitet te prokurimit.

V E N D I M

I. **APROVOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik: **Runway shpk & Sabit Makiqi B.I A&V Collection** lidhur me aktivitetin e prokurimit: *Ritender - Furnizim me jelek taktik - SUFSK 1001 për nevojat e FSK-së* me nr. te prokurimit: 217-25-5993-1-1-1 dhe Nr. i brendshëm: 21700/25/023/111 te iniciuar nga AK- **MINISTRIA E MBROJTJES**

II. **ANULOHET** njoftimi B-58 për anulim te aktivitetit te prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: *Ritender - Furnizim me jelek taktik - SUFSK 1001 për nevojat e FSK-së -me nr. te prokurimit: 217-25-5993-1-1-1 dhe Nr. i brendshëm: 21700/25/023/111 te iniciuar nga AK- **MINISTRIA E MBROJTJES***, dhe lënda kthehet ne **Rivlerësim** dhe pas rivlerësimit te shpallemi fitues i këtij aktiviteti te prokurimit pasi jemi si OE i përgjegjshëm.

8. Dëmet materiale

Shpenzimet mbi angazhimin ne përgatitjen e ofertave, sigurimin e ofertës, shpenzimet për përgatitjen e mostrave 45.000 euro, shpenzimet për punimin ndërkombëtar, shpenzimet për shërbime te avokatisë etj.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura